



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 264/4 Prot.

Tiranë, më 02.02.2026

VENDIM

Nr. 10 Datë 02.02.2026

**“PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONIN E PUNËS "TEKNIK I MESËM I
SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT
TË SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, gërma f), në Statutin e UST-së, kreu V, Neni 66, pika 1, në Rregulloren e UST-së, neni 44 "Personeli Administrativ", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 "Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës", si dhe në shkresën e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse datë 16.01.2026 "Propozim për miratimin e kriterëve për pozicionin e punës "Teknik i Mesëm i Specialiteteve të Ndryshme" në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse", në relacionin e administratorit nr 130/1 prot, dt 16.01.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 02.02.2026

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve për hapjen e procedurave të konkursit për 2 (dy) pozicione pune si "Teknik i Mesëm i Specialiteteve të Ndryshme" në Sektorin e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse:

KRITERE TË PËRGJITHSHME

I.	KRITERE ELEMINESE
1	Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2	Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurron;
3	Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4	Të mos ketë cënuar imazhin e UST-së;

Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve me sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.

Kriteret të veçanta:

1. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm.
2. Të ketë eksperiencë pune përben avantazh.
3. Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup
4. Intervista.

Kandidatët që do të aplikojnë për vendin e punës si "Teknik i Mesëm i Specialiteteve të Ndryshme" duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim,
 2. Një kopje jetëshkrimi e detyrueshme.
 3. Fotokopje e kartës së identitetit
 4. Dëftesë e shkollës (Diplomës/Diplomave) bashkë me listë notash të noterizuara (për ciklet përkatëse të studimit, sipas rastit);
 5. Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim nga institucioni ku ka punuar;
 6. Raport mjeko-ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës.
 7. Dëshmi penaliteti/formular vetëdeklarimi;
 8. Certifikatë personale.
 9. Certifikatë familjare.
-
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtorja e Burimeve Njerezore, Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**Artur COBANI**